



**Hapet thirrja për mobilitete stafi të UPT-së,
për pjesëmarrje në javën ndërkombëtare të trajnimit të stafit,
në Politecnico di Torino (POLITO), Itali,
në kuadër të Programit Erasmus+ KA107.**

Në kuadër bashkëpunimit midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Politecnico di Torino, hapet thirrja për mobilitete për staf të Universitetit Politeknik të Tiranës, në Politecnico di Torino.

Lloji i mobilitetit përfshin: Pjesëmarrje në javën ndërkombëtare të trajnimit të stafit, në Torino, në datat 27-31 maj 2024.

Fushat e aplikimit: Të gjitha njësitë e UPT – së

Kohëzgjatja e mobilitetit: 5 + 2 ditë, 27-31 maj 2024

Numri maksimal i stafit për nominim: 2 (staf administrativ dhe/ose akademik)

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës;
- Plani i propozuar i lëvizshmërisë, "Staff Mobility for Training, Mobility Agreement".
- Të paktën një nivel B2 i gjuhës angleze, ose italiane.

Për të shkarkuar formatin e "Staff Mobility for Training, Mobility Agreement" klikoni te: [Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](https://upt.edu.al) , aneks 3.

Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të prezantojnë Universitetin Politeknik të Tiranës, të ndajnë njohuritë me kolegët, të promovojnë mundësi ndërkombëtare për komunitetin e POLITO-s, të mësojnë më shumë rreth këtij universiteti dhe të vizitojnë qytetin e Torinos.

Një program i detajuar nga POLITO do të jetë i disponueshëm në fillim të vitit 2024.

Nominimet e kandidatëve për këtë aktivitet do të pranohen nga POLITO, duke marrë parasysh një pjesëmarrje të balancuar nga partnerët.



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
Key Action 1
- Mobility for learners and staff -



Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT:

Deri më 10 nëntor 2023, ora 12.00

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al , abego@upt.al